



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 125, datë 27.04.2021

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR ANALIZIMIN E AFTËSIVE
PROFESIONALE TË PROKURORIT
HYSNI MULAJ

Bazuar në nenin 179/b dhe në nenin "E", të Aneksit "Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 40 dhe 42, pika 1, të Ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në nenin 189, pika 1, germa "a", të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar, si dhe pasi u njoh me raportin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Raportit për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit kalimtar, prokurorit **Hysni Mulaj**, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Një kopje e këtij Raporti i dërgohet menjëherë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ANËTAR
MOISI DUDA

ANËTAR
ELOIDA GOXHI